Asistencë për shërbime funerali lidhur me Coronavirus (COVID-19)

Pandemia e COVID-19 ka sjellë hidhërim të madh te shumë familje. Misioni ynë në FEMA është të ndihmojmë njerëzit para, gjatë dhe pas fatkeqësive. Ne jemi të përkushtuar për të ndihmuar në lehtësimin e stresit dhe barrës financiare të shkaktuar nga virusi.

FEMA ju ofron asistencë financiare lidhur me shpenzimet funerale të COVID-19 të kryera pas datës 20 janar 2020.



Për t'u kualifikuar për asistencë për shërbime funerali, duhet të plotësoni këto kushte:

- Vdekja duhet të ketë ndodhur në Shtetet e Bashkuara.
- Aplikuesi duhet të jetë qytetar amerikan, shtetas jo-qytetar amerikan ose shtetas i huaj i kualifikuar që ka kryer shpenzime funerale pas datës 20 janar 2020.
- Nuk ka asnjë kriter që personi i vdekur të ketë qenë qytetar amerikan, shtetas jo-qytetar amerikan ose shtetas i huaj i kualifikuar.
- Certifikata e vdekjes e personit të vdekur duhet të tregojë se vdekja ka ndodhur ose është shkaktuar nga COVID-19. Nëse një vdekje ka ndodhur midis 20 janarit dhe 16 majit 2020 dhe certifikata e vdekjes nuk tregon se vdekja ka ndodhur prej COVID-19, përfshini një deklaratë të nënshkruar nga nëpunësi certifikues i certifikatës së vdekjes, mjeku ligjor ose ekzaminuesi mjekësor lokal që lidh shkakun e vdekjes me COVID-19.

Cilat shpenzime kualifikohen për rimbursim?

Shembuj të shpenzimeve të kualifikuara mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në sa më poshtë:

- Transporti për të identifikuar personin e vdekur
- Transferimi i eshtrave
- Një parcelë varrimi ose një kamare kremimi
- Një shënues ose gur varri
- Shërbime klerikale ose zyrtare
- Përdorimi i pajisjeve ose stafit të shërbimeve të funeralit
- Shpenzime të kremimit ose të varrimit

Çfarë informacioni duhet ti jap FEMA-s?

Përpara se të kontaktoni FEMA-n për të aplikuar, ju lutemi të keni informacionin e mëposhtëm:

- Emri, numri i sigurimeve shoqërore, data e lindjes, adresa postare dhe numrat telefonikë të kontaktit.
- Emri, numri i sigurimeve shoqërore dhe data e lindjes për çdo person të vdekur.
- Vendndodhja ose adresa ku personi i vdekur ndërroi jetë.
- Dokumentacioni dhe mandatet e arkëtimit për çdo asistencë të marrë tashmë nga burime të tjera, përfshirë varrimin ose sigurimin për shërbime funerali, dhurime, agjenci vullnetare, programe të tjera qeveritare ose organizata jofitimprurëse.
- Emri dhe informacioni i çdo bashkë-aplikues (-ve), nëse dikush përveç jush ka kryer shpenzime funerali për individin (-ët) e vdekur.

SI MUND TË APLIKOJ PËR KËTË ASISTENCË?

Telefononi në Numrin e Linjës së Asistencës për Shërbime Funerali për COVID-19 të FEMA-s:
1-844-684-6333
(teletajp-TTY: 800-462-7585)
nga ora 09:00 e mëngjesit deri në orën 21:00 të darkës ET,
nga e hëna në të premte dhe nisni procesin e aplikimit.

Për shërbime më të shpejta pas aplikimit tuaj, ju mund të nisni dërgimin online të dokumentacionit përmes Disasterassistance.gov, **nëpërmjet faksit në numrin 855-261-3452.**

Dokumentet mund të dërgohen gjithashtu me postë në adresën:
COVID-19 Funeral Assistance
P.O. Box 10001
Hyattsville, MD 20782

Ju mund të na vizitoni gjithashtu online në adresën
FEMA.gov/funeral-assistance/faq.
Informacioni mundësohet në disa gjuhë si me telefon, ashtu edhe nëpërmjet faqes ueb.

FEMA